



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 64 datë 23.06.2017

“PËR MIRATIMIN E PAGESËS PËR PAK E INVALIDËT E PUNËS PËR PERIUdhËN 1-30 QERSHOR 2017 DHE MIRATIMIN E KOMPENSIMIT DHE HEQJEN E FASHËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUdhËN MAJ 2017”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neneve 7, 8, 11, 20, 23 dhe nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës” i ndryshuar, ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar, vendimit nr. 277, datë 18.06.1997 të Këshillit Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbërit” i ndryshuar, vendimit nr. 31, datë 20.01.2001 të Këshillit Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar, vendimit nr. 618, datë 07.09.2006 të Këshillit Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar” i ndryshuar, vendimit nr. 869, datë 18.06.2008 të Këshillit Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit të punës”, vendimit nr. 78, datë 07.02.2007 të Këshillit Ministrave “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë” i ndryshuar, vendimit nr.8, datë 14.01.2015 të Këshillit Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj” i ndryshuar, udhëzimit nr. 1, datë 02.02.2015 të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 KWH për faturimin e energjisë elektrike”i ndryshuar, udhëzimit nr.3, datë 10.03.2014 të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar” i ndryshuar, udhëzimit nr. 22, datë 20.08.2015 të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Mbi zbatimin e vendimit nr.618 datë 7.09.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara” i ndryshuar, udhëzimit nr. 9, datë 25.02.2015 të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Mbi zbatimin e vendimit nr. 404, datë 20.06.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së kriterëve dhe procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e

energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”, udhëzimit nr. 23, datë 20.08.2015 të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar, udhëzimit nr. 24, datë 20.08.2015 të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak Tiranë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuar, për periudhen 1-30 Qershor 2017 për Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur.
2. Miratimin e kompensimit dhe heqjen e fashës së energjisë elektrike, për muajin Maj 2017, sipas tabelës nr. 2 bashkëlidhur.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI